



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DEVOLL**  
**SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE**

Nr \_\_\_\_ Prot

Bilisht me \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

**PROCESVERBAL – PROCEDURË E HAPUR E THJESHTUAR - MALLRA**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**- Objekti i procedurës: “Materiale Elektrike”**

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (cpv): “Materiale Elektrike” (31681410-0)**

**Vlera e fondit limit: 4,161,850 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e tetëqind e pesëdhjete ) leke pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Devoll** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

**Argumentimi:** kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 8**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar **duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit te kontrates.**

**Argumentimi:**Ky kriter është vendosur në perputhje me pikën 3 të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të percaktuar se: 3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*; në pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar ku percaktohet se:Pika 1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.Pika2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirine ulët monetar;

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontrates.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/b e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet, përkatësisht; Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c)40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirine ulët monetar; Duke qenë se kjo procedurë prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit nën kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara me pare gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku percaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenin 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku percaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e dy viteve të fundit në perputhje me vlerën e fondit limit të parashikuar.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për pervojen e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të kontrates ,

Për të vërtetuar pervojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për pervojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave të furnizuara.
- b) për pervojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe pikën 4 të nenit 40 dhe pikën 4/b, nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë pervojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë kanë pervojë të mëparshme për procedura të ngjashme me objektin që prokurohet si dhe kanë përmbushur me sukses kontratën për të cilën janë shpallur fitues. Kjo tregon se operatori ekonomik është vazhdimisht i angazhuar në treg me kontrata furnizimi, çka rrit besueshmërinë të Autoriteti Kontraktor se në rast shpallje fitues, ekzekutimi i kontratës do të jetë në përputhje me përcaktimet e DST, dispozitat e kontratës dhe planit të zbatimit të kontratës.

| Nr. | Emertimi                    | Njesia | Sasia |
|-----|-----------------------------|--------|-------|
| 1   | Kabell 2x2.5                | ml     | 1500  |
| 2   | Kabell 2x1.5                | ml     | 1200  |
| 3   | Percjelles i thjeshte 1x2.5 | ml     | 300   |
| 4   | Percjelles 1x1.5            | ml     | 300   |
| 5   | Llamba LED 15W              | cope   | 500   |
| 6   | Portollamba E27             | cope   | 100   |
| 7   | Seuter me bateri            | cope   | 60    |
| 8   | Limitator C 32 A            | cope   | 10    |
| 9   | Llamba LED 30W              | cope   | 300   |
| 10  | Izolant                     | cope   | 250   |
| 11  | Pinca                       | cope   | 5     |

**Mostrat duhet të dorëzohen me një shkresë percjellese në Bashkinë Devoll, në zyrën e protokoll-arkivit, në datën dhe orën e hapjes së tenderit.**

|    |                                    |      |      |
|----|------------------------------------|------|------|
| 12 | Koft preres                        | cope | 5    |
| 13 | Ndricues elektrik led<br>100-130 W | cope | 100  |
| 14 | Ndricues Konik led<br>30-50 W      | cope | 100  |
| 15 | Tube Ø63                           | ml   | 500  |
| 16 | Tube Ø63                           | ml   | 1700 |

**Mos dorezimi i mostrave ne afat do te sjelle skualifikimin e operatorit pjesemarrës.**

**Argumentim:** Referuar VKM nr 285 dt 19.05.2021 “Per Miratimin e rregullave te prokurimit public” neni 40 pika 6 është përcaktuar se:

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

Vendosja e këtij kriteri referuar dhe legjislacionit në fuqi I shërben AK për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të kërkuara duke u niur nga rendesia që ato kanë për shkak të funksionalitetit special të tyre.

2.3.3 Operatori ekonomike duhet të deklarojë që mer persiper transportin e mallrave objekt prokurimi pranë magazines se Bashkise Devoll sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër të kryejnë shërbimin e transportit në adresën e përcaktuar të Autoritetit Kontraktor.. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

**Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.**

Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me nenin 11 të LPP-së dhe në to përcaktohen qartë karakteristika e mallit objekt prokurimi duke mos përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Specifikimet teknike në rastin konkret nuk përbëjnë pengesë për konkurrencën e hapur dhe pjesënarrjen e OE të cilët tregëtojnë materiale elektrike

**Afatet e lëvrimit:**

E gjithë sasia e kërkuar do të lëvrohet nga nënshkrimi i kontratës deri ne dt. 31.12.2024 sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Njesia e Prokurimit: